



---

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data \_\_\_/\_\_\_/2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE ARTIKUJ USHQIMORE PER FURNIZIMIN E KOPSHTEVE, ÇERDHES DHE KONVIKTIT NE ADMINISTRIM TE BASHKISE LEZHE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03140000-4, 03221000-6, 15884000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,283,170 (dhjetë milion e dyqind e tetedhjetë e tre mijë e njëqind e shtatedhjetë) Lek pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlere eshte percaktuar referuar nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Per Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.”*

**2.2.2** Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

---

*ose*

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, si deshmi pranohen vetem faturat tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore ku shenohen data, shumet dhe sherbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar minimalisht **6 (gjashte)** punonjes per periudhen **Qershor 2022 - Gusht 2022**, (kjo per arsye se operatori ekonomik duhet te marre persiper shperndarjen ditore te ushqimeve ne kater pika te ndryshme), e vertetuar kjo me listpagesat per periudhen e kerkuar dhe Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion fuqia punëtore e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Nënvizojmë se kontrata në fjalë është një kontratë furnizimi e cila produktet e bukes, frutrapime dhe artikujt ushqimorë me origjinë shtazore do të kryhet furnizimi periodik dhe ditor duke shpërndarë në të gjithë destinacionet e kerkuara nga AK si kopshtet, cerdhja dhe konvikti në administrim të Bashkisë Lezhe.

Gjithashtu theksojmë rëndësinë që ka furnizimi dhe shpërndarja e ushqimeve, fruta perimeve dhe produkteve të mishit dhe nevojës së personave të specializuar për secilin proces pasi duhet të njohin cilësinë e produktit duke respektuar kushtet e ambalazhimit, transportit dhe shpërndarjes

---

se tyre pasi referuar specifikimeve teknike si dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit vërehet se ky i fundit kërkon të realizojë furnizimin periodik dhe ditor me artikuj ushqimor, fruta-perime, buke dhe artikuj ushqimore me origjine shtazore, sipas kërkeses se Autoritetit kontraktor në të gjitha kopshtet, cerdhen dhe konviktin në administrim të Bashkisë Lezhe. Thëksojmë se këto produkte kërkohen të jenë çdo ditë të freskta dhe të sigurta për konsumim.

Si përfundim kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i licensuar si më poshtë dhe të disponojë:

- License kategoria: II.1.A “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumice e ushqimeve për njërez”, të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- License të leshuar nga QKL me kod II.1.B (Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore për njërez).

*Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njërez” dhe II.1.B “Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore për njërez”.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, po ashtu dhe në përputhje me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Më anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.4** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Çertifikate **ISO 9001:2015** “Per menaxhimin e cilesise”objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.
  - Çertifikate **ISO 22000:2018** “Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore”objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.
-

- Çertifikate **ISO 14001 :2015 "Per sistemin e Menaxhimit te Mjediset"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

**Shënim:** Certifikatat ISO duhet të jenë të lëshuara nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Në rastet e bashkimit** të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata, ISO në përputhje me % e bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, ku parashikohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Referuar natyrës se veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara dhe të disponojnë certifikatat si me poshte:

Çertifikatë **ISO 9001:2015 "Per menaxhimin e cilesise"**, objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj. Me anë të së cilës operatori ekonomik dëshmon se është certifikuar sipas **ISO 9001:2008 mbi "Menaxhimin e cilesise"**,

- Çertifikate **EN-ISO 22000 :2005 "Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj. Me anë të së cilës operatori ekonomik dëshmon se është certifikuar sipas **EN-ISO 22000 :2005, mbi "Sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore,**

- Çertifikate **ISO 14001 :2015 "Per sistemin e Menaxhimit te Mjediset"** objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj. Me anë të së cilës operatori ekonomik dëshmon se është certifikuar sipas **ISO 14001 :2015, mbi "Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit"**,

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qera ose kontrate përdorimi Njese tregtare ushqimore ose ambiente për magazinimin e artikujve të tjere ushqimore, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet Higjeno-Sanitare.

Për të provuar kriterin e mesiperm OE duhet të paraqesë:

- a- kontrate qiraje/ Kontrate Bashkepunimi apo Çertifikata/Vertetim Pronesie,
- b- Akt-Miratim higjeno-sanitare, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor (ISHSH).

**2.3.6** OE duhet të ketë në pronësi/ kontrate qiraje/ Marreveshje bashkepunimi për ambiente të përshtatshme, për magazinimin e mallrave ushqimore me origjinë shtazore, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, ambientet e kërkuara duhet të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare.

*Per produktet me origjinë shtazore, operatori ekonomik duhet të disponojë brenda ambienteve të tij dhomë frigoriferike për magazinimin e produkteve shtazore, vertetur kjo me fature tatimore të shitjes.*

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qira një pikë shitje për fruta perime dhe zarzavate ose të paraqesë kontratë bashkepunimi ku të jetë specifikuar furnizimi në vijimësi e të vazhdueshëm me fruta-perime dhe zarzavate të fresketa për të gjithë periudhën e marreveshjes kuader

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të disponojë një pikë shitje në pronësi ose me qira ose të paraqesë kontratë furnizimi për buke, brenda qytetit Lezhë, ku të jetë specifikuar furnizimi në vijimësi dhe të vazhdueshëm për të gjithë periudhën e marreveshjes kuader.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Automjet ATV (frigorifer) për transportimin e produkteve ushqimor	Cope	1	Pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi
2	Automjet ATV (jo frigorifer) për transportimin e produkteve ushqimor	Cope	1	Pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi

- Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara, OE duhet të paraqesë:
  - a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronësia dhe foto.
  - b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjetit të marrë me qira ose kontratë bashkepunimi të paraqiten si më poshtë:
    - Kontratë notoriale qiraje/ Kontratë Bashkepunimi, me afatë të përcaktuara të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e kontratës.
    - Kontratë notoriale qiraje/ ose kontratë bashkepunimi, të jetë e shoqëruar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronësine dhe foto).

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kriteret e mesipërme janë vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Po ashtu perzgjedhja e ketyre kriterëve eshte bere ne përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit, publikuar ne adresen [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .

Referuar nevojave te Autoritetit Kontraktor, Specifikimeve Teknike dhe preventivit te mallit qe kerkohe te blihet, konstatohet se kërkohet te kryhet furnizimi periodik ditor me mallra ushqimore e kopshteve, cerdhes dhe konviktit, ne administrim te Bashkise Lezhe dhe te shtrira ne territorin e saj me vendodhje te ndryshme si dhe duke mbajtur gjithashtu ne konsiderate qe produktet ushqimore kategorizohen ne Ushqime me origjine shtazore dhe Ushqime me origjine joshtazore, produktet ushqimore te fresketa te fruta-perime dhe produktet ushqimore ku per kete kategori te produkteve duhet te mbahet gjithashtu ne konsiderate qe per te gjithë produktet ushqimore duhet te zbatohen dispozitat e Legjislacionit per Ushqimin, si rrjedhoje shihet e nevojshme qe OE te disponoje ne pronësi, qera ose kontrate përdorimi/bashkepunimi Njesise tregtare ushqimore ose ambiente per magazinimin e artikujve te tjere ushqimore, ambiente te pershtatshme, per magazinimin e mallrave ushqimore me origjine shtazore, te cilat plotesojne kushtet higjeno-sanitare, ku per produktet me origjine shtazore, brenda ambienteve te tij OE duhet te kete te instaluar dhome frigoriferike per magazinimin e këtyre produkteve, nje pike shitje per fruta perime dhe zarzavate, brenda qytetit Lezhe, nje pike shitje per buke, brenda qytetit te Lezhes, si dhe 1 Automjet ATV (frigorifer) per transportimin e produkteve ushqimor dhe 1 Automjet ATV (jo frigorifer) per transportimin e produkteve ushqimor.

Kerkesa per frigoriferet e instaluar ne ambientet e operatorit ekonomik eshte bere sipas Udhezimit te Ministrit te Bujqesise Nr. 22, date 25.11.2010 "*Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor*".

Sa me siper si përfundim keto kriterë janë vendosur ne proporcion me kompleksitetin dhe vlerën e kontrates objekt prokurimi.

---

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetedeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-se, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**2.3.11** Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin një deklaratë nga administratori i shoqërisë për skadencën e produkteve ushqimore, e cila duhet të jetë nga 6 muaj deri në 1 vit nga momenti i levrimit të mallit si dhe furnizimin e plotë për periudhën e zbatimit të kontratës.

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Po ashtu këto kritereve janë vendosur në përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Në lidhje me pikën 2.3.11, theksojmë se me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Njësia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, në të cilën theksojnë se janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njësia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT:**

---